



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS  
OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.767/2013

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, (e vendosur në objektin e Vushtrrisë, degës së kësaj gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përber nga gjyqtari individual **Faton Ademi**, me procesmbajtse ne çështjen juridike të paditësit: , më seli ne , kundët te paditurve dhe te gjithë nga . Baza e kontesit. Pages e Borxhit te Huas, gjykata me dt.12.08.2015, bien ketë:

#### A K T G J Y K I M

**I. APROVONET** padia dhe kërkesëpadia e paditëses me seli në kundër të paditurëve , dhe të gjithë nga , për shkak te pagesës se borxhit lidhur me huan.

**II. OBLIGOHEN** të paditurit qe në emër te borxhit t'ia paguajnë paditëses shumen prej **3284 ( tremijë e dyqindë tetëdhjet e katër ) euro**, në menyrë të njejt pra secili i paditur nga **1094.66 euro**, me kamat prej 8 %, duke filluar që nga plotëfujqishmëria e aktgjykimit e gjer në pagesën definitive të borxhit.

**III. OBLIGOHEN** te paditurit qe ne emër të shpenzimeve proçudrale t'ia paguaj paditëses shumen prej **25 euro**, për shkak te takses për padi, kurse gjykates shumen prej **25 euro**, për shkak te perpilimit të aktgjykimit, te paditurit kanë obligim që t'i përbushin të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotëfujqishmërisë, nen kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

## A r s y e t i m

Paditesja ka ushtruar padi me dt.03.12.2013, kundër te paditurve për shkak te pagesës te huas.

Gjykata me dt. 20.05.2015. ka mbajtur seancën ne të cilën prezantoi paditësja kurse të paditurit nuk prezentuan edhe pse ishin të ftuar me ftesa të rregullta dhe mungesen nuk e kanë arysetuar.

Gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalen përfundimtare i autorizuari i paditses deklaroi: "mbet ne terësi pran padis dhe kërkespadis, pasiqe konsideroj si është bazur duke pas parasyesh kontraten mbi huan te lidhur në mes te paditses dhe të paditurve, kurse i propozoj gjykates qe pas administrimit të provave të aprovoj padin si të bazuar, Kurse shpenzimet e procedurës i kërkoj".

Gjykata duke u bazuar ne nenit 7 dhe 8 të LPK-se, i administroi keto prova: propozimi për sekuestrim të kolateralit i dt.06.11.2007, marrveshja mbi huan e lidhur në mes te paditses dhe te paditurit të parë me dt.08.12.2005, radhitja e flëtpagesave deri me dt.10.12.2007, marrveshja mbi hipoteken e lidhur në mes të paditses dhe të paditurit të parë e nenshkuar nga garantuesit dhe palet me dt.08.12.2005, kopja e letërnjoftimit për te paditurin e parë, kopja e librezes se automjetit për te paditurin e katërt, kopja e librezes se automjetit për te paditurin e dyte, kopja e letërnjoftimit për te paditurin e katërt, kopja e librezes se automjetit për te paditurin e tret, kopja e letërnjoftimit për te paditurin e tret, kopja e letërnjoftimit për te paditurin e parë; në bazë te provave te administruar gjykata konstatoi keto fakte:

Nuk është kontestuse fakti se në mes paditses dhe te paditurit të parë është lidhur marrveshje për marrjen e huas ne shumën prej **20 000 euro**, me dt.08.12.2005, me detyrimin e kthimit të huas për 24 muaj.

Po ashtu është fakt se i padituri i dytë dhe i tret kanë qenë ne cilësinë e garantuesve me rastin e lidhjes se marrveshjes për huancë mes të paditurit të parë dhe paditëses, kurse më ketë rast është lcn hipotekë banesa e te paditurit të pare, kurse i padituri i dytë dhe i tretë kane lenë peng automjetet e tyre.

I padituri i parë ka arritur qe t'ia paguaj paditëses një pjesë të shumës se huas kjo deshmohet edhe më anë të fletëpagesave të cilat i ka prezantuar paditsja si huadhënësi ne ketë marrëveshje.

Mirëpo edhe përkundër qe i padituri i parë i cili është huamarres por edhe i cili ka len hipotekë banesën, kurse i padituri i dytë dhe i tretë si garantues kanë lenë peng automjetet e tyre ne rast te mospageses se huas, nuk kanë arritur qe t'ia paguajn shumen totale të borxhit paditses.

Lidhur me piken **II** të dispozitivit gjykata u bazua ne shkresat e lëndës e sidomos ne marrëveshjen në mes te paditses dhe te paditurve, ku aty ceket qarte se ne rast te mos pageses se borxhit nga ana e te paditurit të parë si huamarrës, garantuesit janë te obliguar qe ne mënyrë solidare të bëjnë pagesën e borxhit per shumen e mbetur ose në terësi borxhin e mbetur.

Mirëpo edhe përkundër te gjitha afateve te cilat i ka jep paditsja të paditurve për t'ia paguar borxhin, te paditurit nuk kanë arritur qe ta eliminojnë në tërësi borxhin i cili së bashku me kamaten e paraparë me irregullat bankare ka arritur shumen e cekur si ne piken **II** të dispozitivit.

Andaj gjykata duke u bazuar ne nenet 375, 378, 382, 385 pika 1, dhe 435 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, vendosi si ne dispozitiv.

Lidhur me shpenzimet gjykata u bazua ne nenin 452 të LPK-se.

Gjykata, aktgjykimin e saj e mbështeti në nenin 143 par.1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.767/2013, me dt.12.08.2015**

**G J Y Q T A R I**  
**Faton Ademi**

**UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa ne afat 15 ditor nga data e pranimit te ketij aktgjykimi, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa ushtrohet nëpërmjet kësaj gjykate.